



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 28 dhjetor 2021
Nr.ref.:RK 1926/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI170/21

Parashtrues

Arianit Sllamniku dhe të tjerët

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Republikës së
Kosovës Nr.01/32 i 28 gushtit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Arianit Sllamniku me vendbanim në Gjilan, dhe Bajram Kurtaj, Filiz Bejtullahu, Erolind Lakna, Endrit Pajaziti, Merita Kryeziu,

Herolind Kryeziu, Arsim Shallci, të përfaqësuar nga dhe Muhamet Mujaj, avokat nga Prishtina, njëkohësisht parashtrues dhe përfaqësues i parashtruesve të kërkesës (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

Akti i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/32 të 28 gushtit 2021 (në tekstin e mëtejme: vendimi i kontestuar).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, përmes së cilit parashtruesit e kërkesës pretendojnë se u janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tyre të garantuara me nenet 26 [E drejta e Integritetit Personal], 35 [Liria e Lëvizjes], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], dhe 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
4. Parashtruesit e kërkesës po ashtu kërkojnë nga Gjykata që të vendos masën e përkohshme *“për shkak se me një vendim të tillë janë duke u paraqitë dëme të pariparueshme tek të gjithë shërbyesit civil, zyrtarët shtetërorë, familjet e tyre dhe qytetarët në përgjithësi”*.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 27 (Masat e përkohshme) e 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) dhe 56 (Kërkesa për masë të përkohshme) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

6. Më 13 shtator 2021, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës z. Arianit Sllamniku e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 14 shtator 2021, përfaqësuesi i parashtruesit Arianit Sllamniku, dorëzoi në Gjykatë autorizimin e vlefshëm dhe një Njoftim të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, bazuar në të cilën kërkohen dokumentet përkatëse për hyrje në objekt të kësaj të fundit. Gjithashtu, parashtruesi dorëzoi një letër përmes së cilës deklaroi se *“Vlen të ceket se dje nuk u lejuam nga zyrtarët policor të futemi brenda në objekt të Gjykatës Kushtetuese për shkak të këtij vendimi Qeveritar dhe njoftimit të datës 10.09.2021, tek pasi reagoi administrata na u lejua dorëzimi i kërkesës.”*

8. Më 17 shtator 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi, Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
9. Më 23 shtator 2021, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës z. Arianit Sllamniku për regjistrimin e kërkesës, dhe njëkohësisht kërkoi nga ai që të (i) sqarojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se u janë cenuar përmes Vendimit të Qeverisë [nr.01/32] i 28 gushtit 2021, dhe t'i elaborojë ato; dhe (ii) të dorëzojë në Gjykatë dëshmitë përkatëse që tregojnë/apo dëshmojnë se si është i afektuar nga Vendimi i Qeverisë [nr.01/32] i 28 gushtit 2021, të cilin e konteston. Njëkohësisht Gjykata kërkoi që parashtruesi i kërkesës z. Sllamniku, të dorëzojë një kopje të kartelës apo dëshmisë tjetër përkatëse që tregon se është i punësuar në institucionet publike apo private.
10. Më 1 tetor 2021, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës, dorëzoi një parashtrësë me informata shtesë, dhe në të bashkëngjiti edhe parashtrues të tjerë.
11. Më 11 tetor 2021, Gjykata kërkoi nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës të (i) specifikojë se a është edhe ai parashtrues në rastin KI170/21; dhe (ii) të dorëzojë autorizimet për 7 (shtatë) parashtrues tjerë. Gjykata poashtu kërkoi nga përfaqësuesi edhe plotësimin e formularit të ri të kërkesës.
12. Më 15 tetor 2021, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës, dorëzoi autorizimet përkatëse dhe sqaroi se konsideron se ka të dhëna të mjaftueshme në parashtrësat e tij, dhe rrjedhimisht nuk dorëzoi formularin e ri të kërkesës.
13. Më 22 tetor 2021, Gjykata njoftoi edhe Kryeministrin e Republikës së Kosovës, për regjistrimin e kërkesës.
14. Më 6 dhjetor 2021, parashtruesit e kërkesës e sollën një dokument shtesë në Gjykatë, përkatësisht Vendimin e Qeverisë për *"Masat e Përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19"* të 30 nëntorit 2021. Parashtruesit e kërkesës poashtu shtojnë pretendimin se *"me vendime të tilla kjo Qeveri ka dalë jashtë autorizimeve ligjore dhe kushtetuese meqë ka nxjerr vendime të cilat nuk gjejnë mbështetje në asnjë ligj dhe se masat cenojnë liritë dhe të drejtat e njeriut që parasheh Kushtetuta"*.
15. Më 10 dhjetor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

16. Më 28 gusht 2021, Qeveria nxjerr Vendimin nr.01/32 *"Për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19"*. Ky vendim nën pikat: (A) do të zbatohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës, dhe parasheh kufizime lidhur me (B) Hyrjet e daljet e qytetarëve në dhe nga Republika e Kosovës; (C) Mbrojtjen dhe sigurinë në punë; (Ç) Masat e përgjithshme të mbrojtjes dhe higjienës; (D) Kufizimin e qarkullimit; (DH) institucionet e arsimit; (E) Paraqitjen dhe skemat sociale pensionale; (F) Kufizimin e mbledhjeve publike dhe private; (G) Ndalimin e veprimtarive dhe

organizimeve të caktuara; (GJ) Gastronominë; (H) Qendrat tregtare dhe operatorët e tjerë ekonomikë; (I) Punëm me palë; (J) Transportin publik; (K) Teatrot dhe bibliotekat; dhe (L) Sportin dhe rekreacionin.

17. Në mes tjerash, dhe për qëllime të rastit pranë nesh, Vendimi i kontestuar parasheh specifikisht:

“B. [Hyrjet dhe daljet e qytetarëve në dhe nga Republika e Kosovës]

2. Nga data 30 gusht deri me datë 13 shtator 2021, çdo person i cili hyn në Republikën e Kosovës duhet të posedoj një nga dëshmitë e mëposhtme:

2.1 Certifikatën e vaksinimit për vaksinimin e plotë (me dy doza) kundër COVID-19;

2.2 Testi RT-PCR negativ për COVID-19, jo më i vjetër se 72 orë

2.3 Dëshmi se personi ka kaluar COVID-19 (test RT-PCR pozitiv i lëshuar jo më pak se 21 ditë dhe jo më shumë se 180 ditë ose rezultat pozitiv i testit të antittrupave serologjik –IgG, i lëshuar më së shumti para 30 ditëve

2.4. Test i shpejtë antigjen negativ jo më i vjetër se 48 orë.

C. [Mbrojtja dhe Siguria në Punë]

8. "Nga data 13 shtator 2021, të gjithë punonjësit e institucioneve publike, si dhe personeli i ndërmarrjeve publike në pronësi të Qeverisë apo të një komune, duhet të posedojnë një nga dëshmitë e cekura në pikën 2.1 deri 2.4, në mënyrë që t'ju lejohet hyrja në ambientet e punës".

Dh. [Institucionet e arsimit]

22. "Nga data 13 shtator 2021, stafi në të gjitha institucionet publike dhe private të të gjitha niveleve të arsimit duhet të posedojnë ndonjërin nga dëshmitë e cekura në pikën 2.1 deri 2.4 "

L. [Sporti dhe rekreacioni]

56. "Shikuesit në aktivitetet garuese në hapësira të jashtme, duhet të posedojnë një nga dëshmitë e cekura në pikën 2.1 deri 2.4.

[...]

58. Lejohet shfrytëzimi i fitneseve, palestrave dhe të ngjashme për aktivitetet individuale rekreative. Klientët duhet të posedojnë ndonjërin nga dëshmitë e përcaktuara në pikën 2.1 deri 2.4 të këtij vendimi."

18. Më 10 shtator 2021, sipas shkresave të lëndës, Ministria e Punëve të Brendshme (në tekstin e mëtejshëm: MPB) kishte lëshuar një Njoftim me nr. 887 përmes të cilit në kuadër të Vendimit nr.01/32, nga 13 shtatori 2021, nuk lejohet hyrja në objektet e MPB-së pa prezantuar dëshmitë si në pikën 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të Vendimit të kontestuar. Gjithashtu ky njoftim shënon që nëse zyrtarët nuk qasen në vendin e punës për shkak të mungesës së dëshmimeve, do konsiderohet si mos-paraqitje në vendin e punës pa arsye.

19. Rrjedhimisht, parashtruesit e kërkesës, pranë Gjykatës theksojnë se janë prekur nga Vendimi i kontestuar, duke mos iu lejuar hyrja në institucione përkatëse, apo në vendin e punës.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

20. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Vendimi i kontestuar i Qeverisë është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tyre të garantuara me nenet 26 [E drejta e Integritetit Personal], 35 [Liria e Lëvizjes], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], dhe 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] të Kushtetutës.
21. Më konkretisht parashtruesit e kërkesës i referohen pjesës B pikave 2.1, 2.2, 2.3, pjesës C pikës 8, pjesës DH pikës 22 dhe pjesës L pikës 56 dhe 58 të Vendimit të kontestuar.
22. Parashtruesit e kërkesës në këtë aspekt theksojnë se Vendimi i kontestuar cenon rëndë të drejtat dhe liritë themelore sepse zyrtarët e administratës publike dhe zyrtarët tjerë shtetërorë dhe qytetarët në përgjithësi kushtëzohen me vendin e tyre të punës me qëllim të marrjes së vaksinës. Andaj parashtruesit e kërkesës i referohen dëshmimeve në paragrafin 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të Vendimit të kontestuar. Ata theksojnë se nga 13 shtatori 2021, datë kjo që hyn në fuqi Vendimi i kontestuar, nuk kanë mundur të shkojnë në punë.
23. Sipas parashtruesve të kërkesës bazuar në Njoftimin e MPB-së, parashtruesit e kanë kuptuar që ky vendim nuk vlen vetëm për të punësuarit në institucione publike dhe private, por edhe të gjithë qytetarët që duan të kenë qasje në këto institucione. Me këtë, rast, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se “kërcënim” për t’u vaksinuar, paraqet ndërhyrje serioze të Qeverisë në sferën private të qytetarëve.
24. Lidhur me çështjen e vaksinimit, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se forma e tillë e presionit duke kushtëzuar edhe vende pune, nuk ka bazë në asnjë ligj të nxjerrë nga Kuvendi, dhe argumentojnë se Ligji nr.07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid 19 ka paraparë në nenin 16 [Vaksinimi] obligimin që Qeveria të sigurojë për të gjithë qytetarët vaksina të mjaftueshme kundër virusit Covid-19, por jo detyrimin për t’u vaksinuar. Sipas parashtruesve, as në nenin 17, 11 e 12 të Ligjit për Luftimin e Pandemisë Covid 19, nuk parasheh masën e tillë.
25. Më tej, parashtruesit e kërkesës kontestojnë vërtetësinë e vaksinave dhe e konsiderojnë paradoks faktin që vendimi i kontestuar i ofron qytetarit vaksinë falas por jo teste të shpeshta mjekësore, të cilat qytetari duhet të i paguajë vetë.
26. Më tej, parashtruesi i kërkesës Muhamet Mujaj thekson se edhe ai si avokat është prekur nga vendimi i tillë, sepse nuk mund të hyjë në institucione të drejtësisë, pa poseduar certifikatën e vaksinimit apo dëshmitë tjera.

27. Në fund, parashtruesit e kërkesës theksojnë se përpos Vendimit të kontestuar të Qeverisë, është edhe Vendimi i MPB-së, i cili paraqet shkelje serioze kushtetuese dhe tejkalon kufijtë e Vendimit të kontestuar sepse nuk lejon qytetarët që të futen në objekte institucionale pa kriteret e kërkuara, dhe punëtorët që nuk paraqesin dëshmitë nga pika 2.1, 2.2, 2.3, dhe 2.4 nuk do lejohen të hyjnë në vendin e punës. Me këtë rast, mungesa e paarsyeshme në punë, nënkupton ndërprerje e kontratës së punës.
28. Parashtruesit e kërkesës i referohen edhe Aktgjykimeve të Gjykatës KO54/20 dhe KO61/20, sipas të cilave *“liritë dhe të drejtat e njeriut mund të kufizohen vetëm me ligj”*. Me këtë rast, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se fjala është për vaksinim të detyruar në mënyrë të tërthortë. Me këtë, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se një ndërhyrje në të drejtat dhe liritë themelore duhet të jetë *“e përcaktuar në ligj”*, të ndjek një *“qëllim legjitim”*, të jetë *“proporcionale”* dhe e *“nevojshme në një shoqëri demokratike”*.
29. Në fund, Parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se ky vendim është akt administrativ i përgjithshëm pa të drejtë apelimi, ku përfshihen të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.
30. Përfundimisht, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të (i) vendosë masën e përkohshme; dhe (ii) të pezullojë dhe hedhë poshtë Vendimin e kontestuar.

Dispozitat Relevante Ligjore

LIGJI NR. 07/L-006 PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E PANDEMISË COVID-19 NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 4

Autorizimet e Ministrisë së Shëndetësisë

1. Në kohën sa zgjatë pandemia COVID-19, përveç autorizimeve nga Ligji Nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse dhe Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, Ministria e Shëndetësisë ka autorizime për sa vijon:

1.1. Kufizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, përjashtimisht ato të specifikuara në nenin 56(2) të Kushtetutës, për aq sa një gjë e tillë është e domosdoshme për luftimin dhe pengimin e përhapjes së sëmundjes COVID-19;

1.2. Kufizimi nga pika e mësipërme duhet të specifikohen në vendimet nga neni 5 i këtij ligji, i cili duhet të përmbajë arsyetimin për kufizim, të drejtën apo lirinë që kufizohet, si dhe të dhëna të tjera që mjaftueshëm sqarojnë qytetarin për liritë dhe të drejtat që janë kufizuar;

1.3. Kufizimi i lirive dhe të drejtave nuk guxon të prekë esencën e së drejtës apo lirisë që kufizohet, duhet të jetë i përkohshëm, i arsyetuar mirë dhe i qashtëm për publikun në një afat sa më të arsyeshëm;

1.4. Autorizimet lidhur me zbatimin e kufizimeve të lirive dhe të drejtave të njeriut si dhe menaxhimi i tyre nuk guxojnë të ndërhyjnë në ushtrimin e rregullt të mandatit dhe kompetencave të organeve shtetërore dhe

institucioneve të specifikuara në këtë ligj. Çdo kufizim i ushtrimit të kompetencave të institucioneve të tjera duhet të specifikohet dhe arsyetohet shprehimisht në vendim të autoritetit përkatës shtetëror dhe të ofrohen arsye për një gjë të tillë;

1.5. Kufizimi i lirive dhe të drejtave që kanë të bëjnë me të drejtat kushtetuese të lirisë së lëvizjes (Neni 35), lirisë e tubimit (Neni 43) dhe privatësisë (Neni 36) bëhet ashtu që jepen arsye time të bollshme dhe të detajuara që dëshmojnë për lidhjen e drejtpërdrejtë në mes të kufizimit dhe masave të ndërmarra për luftimin dhe pengimin e përhapjes së sëmundjes COVID-19.

2. Qeveria e Republikës së Kosovës ruan të drejtën e kontrollit të ligjshmërisë së brendshme në shkallë të parë të veprimeve dhe aktiviteteve të ndërmarra nga MSH nga paragrafi i parë i këtij neni, në veçanti nëse masat e ndërmarra kufizojnë liritë dhe të drejtat sipas nenit 55 të Kushtetutës për një kohë më të gjatë se 30 ditë.

Neni 5

Autorizimet e posaçme të Ministrit të Shëndetësisë

2. Vendimet e Ministrit të Shëndetësisë duhet të jenë të dy llojta: vendime kuadër dhe vendime operationale:

1.4. Vendimet kuadër i nënshtrohen miratimit të Qeverisë;

Neni 6

Kujdesi për disa kufizime të posaçme

1. Në mënyrë të përshtatshme zbatohen edhe dispozitat e Ligjit nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse, në veçanti sa i përket kufizimeve të lirive dhe të drejtave të njeriut që kanë të bëjnë me lirinë e lëvizjes, lirinë e tubimit dhe të drejtën e privatësisë. [...]

Neni 10

Masat për mbrojtjen nga pandemia COVID-19

1. Qeveria miraton strategjinë, programin dhe cakton masat për parandalimin, menaxhimin dhe kontrollin e pandemisë COVID-19.

2. Çdo person ka të drejtë të përfitojë nga masat për mbrojtjen nga COVID-19. Në kuadër të mbrojtjes së popullsisë nga pandemia COVID-19, Qeveria e Kosovës, siguron mjete materiale shtesë për rastet emergjente:

2.1. Për ushtrimin e kontrollit në kufijtë e Kosovës dhe për zbatimin emasave lidhur me ushtrimin e këtij kontrolli;

2.2. Për mbulimin e shpenzimeve të izolimit, të ekzaminimit dhe të mjekimit në institucionet publike shëndetësore të personave të sëmurë dhe të personave për të cilët dyshohet se vuajnë nga COVID-19;

2.3. Për mbulimin e shpenzimeve të karantinës, të kontrollit kufitarë dhe kontrolleve tjera me qëllim të parandalimit të përhapjes së pandemisë COVID-19.

3. Policia e Kosovës, në kuadër të të drejtave dhe të detyrave të veta bashkëpunon me organin kompetent Inspektoratin Shëndetësorë,

Inspektoratin Sanitar, IKSHPK-në, MSH për të asistuar në procedurat e izolimit, kufizimit ose të ndalimit të udhëtimit në vendin apo nga vendi ku është e përhapur pandemia COVID-19.

4. Çdo person, institucion publik, privat apo publiko-privat, kanë për detyrë që të zbatojnë masat e përcaktuara nga organet kompetente, për mbrojtjen nga COVID-19.

5. Institucionet dhe personat kanë për obligim që të zbatojnë masat mbrojtëse me qëllim të identifikimit të agjentëve infektues, burimeve të infeksionit, ndërprerjes së transmetimit, me qëllim të kontrollit, eliminimit dhe zhdukjen e sëmundjes COVID-19.

6. Sipas rekomandimeve të OBSH-së dhe IKSHPK-së, Ministria e Shëndetësisë publikon masat mbrojtëse të detyrueshme për persona dhe institucione. Vendimi për masat mbrojtëse duhet të përfshijë edhe sqarimin se mos zbatimi i cilave masa mbrojtëse është kundërvajtje ligjore apo vepër penale.

7. Mos respektimi i masave mbrojtëse përbën shkelje ligjore e cila ndëshkohet me këtë ligj dhe dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 12

Masat e veçanta

1. Masat e veçanta për parandalimin e COVID-19 janë:
1.1. zbulimi në kohë i burimit të infeksionit dhe rrugëve të marrjes e përhapjes së tij;

1.2. testimi përmes analizave mikrobiologjike i personave të dyshuar me COVID-19;

1.3. përcjellja epidemiologjike dhe njoftimi i hershëm dhe i shpejtë;

1.4. izolimi dhe karantina;

1.5. transportimi i sigurt;

1.6. diagnoza e saktë dhe në kohë reale mikrobiologjike;

1.7. trajtimi dhe shërimi i personave të sëmurë;

1.8. gjurmimi i kontakteve me persona të infektuar apo të sëmurë, sipas udhëzimeve të IKSHPK-së dhe OBSH-së;

1.9. mbikëqyrja shëndetësore e personave të infektuar.

2. MSH dhe IKSHPK me qëllim të parandalimit dhe të luftimit të pandemisë COVID-19 aprovon strategjinë për testimet masive dhe rasteve të kontaktit.

3. MSH dhe IKSHPK aprovojnë protokollet dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për personat që hyjnë në Kosovës nga vende ku ekziston COVID 19, si dhe u japin udhëzime qytetarëve që udhëtojnë në vendet ku ekziston COVID-19.

4. Për të mbrojtur popullatën nga COVID-19, Ministri i Shëndetësisë, në përputhje me rekomandimet e IKSHPK-së, OBSH-së, miraton masa të veçanta për mbrojtje nga COVID-19, si vijon:

4.1. kufizimin ose ndalimin e udhëtimeve në vendin ku është përhapur pandemia COVID-19;

4.2. kufizimin ose ndalimin e qarkullimit në rajonet e infektuara ose të rrezikuara;

- 4.3. kufizimin ose ndalimin e qarkullimit të llojeve të ndryshme të mallrave dhe produkteve;
- 4.4. marrjen pjesë, në mënyrë të detyrueshme, të institucioneve shëndetësore dhe institucioneve të tjera, si dhe të qytetarëve në luftimin e pandemisë COVID-19;
- 4.5. shfrytëzimin e objekteve dhe mjeteve të transportit;
- 4.6. mbyllja e shkollave;
- 4.7. mbyllja e aktiviteteve jopublike apo publike;
- 4.8. anulimi i grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura;
- 4.9. kufizimi apo ndalimi i lëvizjeve me mjetet e transportit publik;
- 4.10. kufizimi i lëvizjeve brenda vendit.

LIGJI Nr. 04/L-125 PËR SHËNDETËSI

Neni 89 Përgjegjësitë e Ministrisë

- 1. Zbatimi i kujdesit shëndetësor gjatë gjendjes së emergjencës sigurohet nga ana e Ministrisë në pajtim me këtë ligj dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
- 2. Aktivitetet e kujdesit shëndetësor në rastet e emergjencës nga paragrafi 1. i këtij neni përfshijnë:
 - 2.1. zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi;
 - 2.2. adaptimin e sistemit të kujdesit shëndetësor në përputhje me planin emergjent;
 - 2.3. zbatimin e ndryshimeve në sistemin e referimit dhe të udhëheqjes;
 - 2.4. sigurimin e shërbimit emergjent të kujdesit shëndetësor për qytetarët;
 - 2.5. veprimin e institucioneve të përkohshme shëndetësore;
 - 2.6. aktivizimin e kapaciteteve plotësuese dhe të rezervave.
- 3. Gjatë gjendjeve emergjente të drejtat e qytetarëve të përcaktuara me ligje, do të garantohen deri në masën që nuk e rrezikon efikasitetin e masave të ndërmarra për tejkalimin e tyre.
- 4. Dinjiteti i qytetarit do të respektohet në tërësi dhe vazhdimisht, pavarësisht nga kufizimet që i përcakton paragrafi 3. i këtij neni.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

- 31. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
- 32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

33. Gjykata po ashtu i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, e të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi.”

34. Më tej, Gjykata vlerëson nëse janë plotësuar kriteret e parapara me rregullin 39 (1) (a) të Rregullores së punës, i cili përcakton që:

*“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:
(a) Kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar”.*

35. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit nr. 01/32 i Qeverisë i 28 gushtit 2021. Ky vendim është nxjerrë nga Qeveria për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19.

36. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se janë të prekur nga vendimi i kontestuar duke theksuar, mes tjerash, se nuk mund të hyjnë në institucione, pa poseduar certifikatën e vaksinimit apo dëshmitë tjera dhe njëkohësisht ankohen në përgjithësi për shkelje kushtetuese në emër të qytetarëve, lidhur me çështjen e

vaksinave dhe kërkesën për certifikatën e vaksinave duke theksuar se qytetarët kushtëzohen me vendin e tyre të punës me qëllim të marrjes së vaksinës. Madje parashtruesit e kërkesës në vetë kërkesën e tyre për masë të përkohshme, theksojnë se Vendimi i kontestuar paraqet dëme të pariparueshme “tek të gjithë shërbyesit civil, zyrtarët shtetërorë, familjet e tyre dhe qytetarët në përgjithësi”.

37. Fillimisht, Gjykata thekson se Vendimi i Qeverisë nr. 01/32 i 28 gushtit 2021, për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, është akt normativ i karakterit të përgjithshëm.
38. Në këtë kontekst, për sa i përket kërkesës së parashtruesve të kërkesës për vlerësim të kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar, Gjykata thekson qëndrimin e saj konsistent se personat fizikë ose juridikë, në kuptim të Nenit 113 paragrafi 7 i Kushtetutës, nuk janë palë të autorizuar që të kërkojnë vlerësim abstrakt të përputhshmërisë së legjislacionit me Kushtetutën, apo kërkesa të natyrës *actio popularis*. Pra, në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata në vazhdimësi ka theksuar se individët nuk mund të kontestojnë in abstracto akte normative të karakterit të përgjithshëm (shih rastin e Gjykatës KI122/20, parashtrues: *Rijad Isufi*, Aktvendim për papranueshmëri i 20 janarit 2021, paragrafi 25-26 dhe referencat e përdorura aty).
39. Gjykata ripërtëritë faktin se Kushtetuta nuk parasheh të drejtën e individëve që të paraqesin kërkesë për kontroll kushtetues abstrakt, gjegjësisht t’i kontestojnë drejtpërsëdrejti në Gjykatën Kushtetuese aktet e përgjithshme normative të autoriteteve publike. Kushtetuta ofron mbrojtje për individët sa i përket veprimeve ose mosveprimeve të autoriteteve publike, vetëm përbrenda fushëveprimit të përcaktuar me nenin 113 paragrafi 7 të Kushtetutës. Këto dispozita kushtetuese kërkojnë nga parashtruesit e kërkesave kushtetuese që të dëshmojnë se: (1) janë palë të autorizuar; (2) janë të prekur drejtpërsëdrejti nga akti konkret ose mosveprimi i autoriteteve publike; dhe (3) kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. (Shih, rastet e Gjykatës: KI21/19, parashtrues *Pjetër Boçi*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 majit 2019 – ku ishte kërkuar interpretim i legjislacionit relevant në lidhje me definimin e “pozitës zyrtare”, paragrafët 21-28 dhe referencat e cituara aty; KI92/12 parashtrues *Sali Hajdari*, Aktvendim për papranueshmëri i 6 dhjetorit 2012 – ku ishte kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit për Pensionet; KI62/12 parashtrues *Liridon Aliu*; Aktvendim për papranueshmëri i 20 shtatorit 2012 – ku ishte kërkuar interpretim i Kushtetutës; KI40/11 parashtrues *Zef Prenaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 shtatorit 2011 – ku ishte kërkuar vlerësim i kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ nr. 11/2010 për pagesën e pensionit themelore të nxjerrë nga MPMS në tetor të vitit 2010; KI102/17 parashtrues *Meleq Ymeri*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 janarit 2018, paragrafi 20; dhe KI113/19, paragrafi 29).
40. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata nuk sheh ndonjë rrethanë apo arsye të vendosë ndryshe nga praktika e saj e gjyqësore në raste të ngjashme.
41. Megjithatë, Gjykata rithekson se individët kanë të drejtë të kontestojnë vetëm aktet individuale të autoriteteve publike që cenojnë të drejtat e tyre individuale

dhe vetëm pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike, të përcaktuara me paragrafin 7, të nenit 113 të Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës KI30/19, parashtrues *Isni Kryeziu*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 prillit 2019, paragrafi 30). Në lidhje me pretendimet e parashtruesve për masat e ndërmarra nga autoritetet publike, Gjykata konsideron se Ligji për Konfliktet Administrative nr. 03/L-202 (në tekstin e mëtejshëm: LKA), ofron mjete juridike për zgjidhjen e rastit të parashtruesve të kërkesës.

42. Në dritë të kësaj që u tha më lart, kërkesa e parashtruesve të kërkesës duhet të shpallet e papranueshme sepse nuk është dorëzuar nga një palë e autorizuar, siç përcaktohet me paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit si dhe rregullin 39 (1) (a) të Rregullores së punës.

Kërkesa për masë të përkohshme

43. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, gjithashtu kërkon nga Gjykata që të nxjerrë vendim për vendosjen e masës së përkohshme, *“për shkak se me një vendim të tillë janë duke u paraqitë dëme të pariparueshme tek të gjithë shërbyesit civil, zyrtarët shtetërorë, familjet e tyre dhe qytetarët në përgjithësi”*.
44. Megjithatë, Gjykata konkludoi se kërkesa e parashtruesve të kërkesës nuk i përmbush kriteret procedurale të pranueshmërisë.
45. Prandaj, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 27 (Masat e përkohshme) të Ligjit dhe pikën (a) të paragrafit (4) të rregullit 57 (Vendimi për masë të përkohshme) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesve të kërkesës për masë të përkohshme duhet të refuzohet, sepse e njëjta nuk mund të jetë objekt shqyrtimi, pasi kërkesa të deklarohej e papranueshme. (Shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: KI107/19, me parashtrues *Gafurr Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 21 prillit 2020, paragrafët 88-90; KI159/18, me parashtrues *Azem Duraku*, Aktvendim për papranueshmëri i 6 majit 2019, paragrafët 89-91; KI19/19 e KI20/19, parashtrues *Muhamed Thaqi dhe Egzon Keka*, Aktvendim për papranueshmëri i 26 gushtit 2019, paragrafët 53- 55;)

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 20 dhe 47 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin dhe 39 (1) (a) dhe 57 të Rregullores së punës, më 10 dhjetor 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani